



SAFEJOURNALISTS.NET

Drejtuar: Znj. Elisa Spiropali, Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Për Dijeni: Znj. Ina Zhupa, Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

Znj. Jorida Tabaku, Kryetare e Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

Z. Genci Gjonçaj, Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Beograd, 18 Tetor 2024

### **Shqetësime të përsëritura për aksesin e gazetarëve në Kuvendin e Shqipërisë**

E nderuar Znj. Spiropali,

Po shkruaj në emër të Rrjetit [SafeJournalists](#), i cili përfaqëson profesionistët e medias në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë gazetarë nga Shqipëria. Rrjeti ynë është i përkushtuar për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve, garantimin e sigurisë së tyre dhe mbrojtjen e lirisë së medias. Ne monitorojmë nga afër zhvillimet në lidhje me median në të gjithë rajonin, veçanërisht në Shqipëri.

Ne dëshirojmë të shprehim shqetësimin tonë në lidhje me [veprimet](#) e Gardës së Republikës më 17 tetor 2024, të cilat pasqyrojnë një model të përsëritur dhe shqetësues të pengimit të aksesit të gazetarëve dhe cënimit të lirisë së medias. Atë ditë gazetarëve që mbulonin zhvillimet parlamentare iu mohua aksesin nga Garda. Ata jo vetëm që u penguan të filmojnin në hyrje, ku deputetët po vinin mes tensioneve të shtuara, por u ndalua edhe hyrja në vetë seancën plenare sipas raportimeve të vetë gazetarëve dhe reporterëve.

Ky incident nuk është i izoluar, por pjesë e një modeli shqetësues, të përsëritur të kufizimit të aksesit të medias brenda Kuvendit të Shqipërisë. Incidente të ngjashme u dokumentuan nga Rrjeti i SafeJournalists gjatë vitit të kaluar, përfshirë më 9 tetor 2023, kur gazetarëve iu [mohua qasja në ambientet parlamentare](#) me arsyetime të paqarta. Incidente të tjera pasuan në vitin 2024: Më 6 shkurt gazetari Ardit Hoxha u [shty fizikisht dhe u largua](#) nga Garda, duke e penguar të filmonte; më 17 maj, ekipeve mediatike u [ndaluan të filmojnin](#) një takim me gazetarët e shkarkuar të RTSH-së, pavarësisht kërkesës formale dhe njoftimit publik; më 30 maj, gazetarët u [penguan gjatë një seance plenare](#) teksa Garda tentoi t'i largonte nga galeria. Së fundmi, më 3 tetor 2024, gazetarët u [penguan fizikisht të hynin në zhvillimet parlamentare](#) kur hyrja kryesore ishte mbyllur qëllimisht.

E drejta e gazetarëve për të hyrë në institucionet publike dhe për të raportuar mbi procedurat parlamentare është themelore për lirinë e medias. Duke kufizuar këtë akses, veprimet e Gardës së Republikës minojnë këto mbrojtje thelbësore dhe kontribuojnë në një mjedis armiqësor për shtypin,

duke kufizuar në fund aftësinë e publikut për të qëndruar të informuar dhe për t'i kërkuar llogari drejtuesve të tyre.

Duke pasur parasysh tensionet dhe konfrontimet e rritura brenda Parlamentit, është thelbësore të respektohen standardet më të larta të transparencës dhe llogaridhënies. Kjo është thelbësore për të siguruar që gazetarët të mund të operojnë në një mjedis të sigurt dhe mbështetës, duke i lejuar ata të kryejnë rolin e tyre kritik të raportimit të lirë dhe të pavarur për procedurat parlamentare.

Ne i bëjmë thirrje Kuvendit të Shqipërisë që ta trajtojë këtë çështje me urgjencën dhe seriozitetin që e kërkon, duke marrë parasysh shqetësimet e ngritura nga gazetarët. Shpresojmë që do të ndërmerren hapa të menjëhershëm për të krijuar një mjedis ku gazetarët mund të ushtrorjnë të drejtën e tyre për të raportuar lirisht, pasi kjo është një shtyllë themelore e çdo shoqërie demokratike.

Çdo sulm ndaj gazetarëve është sulm ndaj interesit publik, demokracisë dhe të drejtave të të gjithë qytetarëve.

Mezi presim të dëgjojmë nga ju.  
Me konsideratë!

Tamara Filipović Stevanović,  
Kordinatore e Rrjetit SafeJournalists

Në emër të  
Shoqata e Gazetarëve të Bosnje dhe Hercegovinës  
Sindikata e Mediave të Malit të Zi  
Shoqata e Gazetarëve Kroatë  
Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës  
Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë  
Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë